



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 12 (e) Ligji nr. 2003/5 i Kosovës për Farëra, dt. 15 Prill 2003,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.08/2009

Për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për Vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet taksa për licencimin e subjekteve që merren me testimin e varieteteve për Vlerën kultivuese prodhuese - VKP dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave.

Neni 2
Licencimi

Subjektet që merren me ushtrimin e veprimtarisë për import, tregtim, prodhim, përpunim dhe paketim të farës, duhet të aplikojnë për licencim në Departamentin e Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 3
Dokumentacioni për licencim si importues, prodhues, përpunues dhe paketues i farërave

1. Kërkesës për licencë për importim, prodhim, përpunim dhe paketim të farës, duhet t'i bashkëngjitet:

- 1.1 Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit;
- 1.2 Informatën e biznesit;
- 1.3 Diploma e Fakultetit të Bujqësisë;
- 1.4 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos;
- 1.5 Dëshmia mbi pagesën e taksës për licencim.

2. Kërkesë për vazhdim të licencimit si importues, prodhues, përpunues dhe paketim të farërave:

- 1.1 Licenca paraprake e lëshuar nga MBPZHR;
- 1.2 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos,
- 1.3 Dëshminë mbi pagesën e taksës për vazhdim të licencimit.

Neni 4

Dokumentacioni për licencim si tregtues i farërave

1. Kërkesës për licencë për tregtim të farës, duhet bashkangjitur këtë dokumentacion:

- 1.1 Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit;
- 1.2 Informata e biznesit;
- 1.3 Diploma e Shkollës Mesme Bujqësore;
- 1.4 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos;
- 1.5 Dëshminë mbi pagesën e taksës për licencim

2. Kërkesë për vazhdim të licencimit si tregtues i farërave duhet ti bashkëngjitet:

- 1.1 Licenca paraprake e lëshuar nga MBPZHR;
- 1.2 Procesverbalin e inspektorit fitosanitar për vlerësimin e gjendjes së depos,
- 1.3 Dëshminë mbi pagesën e taksës për vazhdim të licencimit.

Neni 5

Shqyrtimi i kërkesave për licencim

1. Shqyrtimi i kërkesave për licencim nga neni 2 i këtij udhëzimi administrativ bëhet nga Komisioni i veçantë për licencim në kuadër të Departamentit të Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve.

2. Subjektet afaristë të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me Ligji i Kosovës për Farërat Nr. 2003/5 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.05/2005 për Regjistrimin dhe Licencim në lëmin e Farërave dhe Aplikimin e tyre në Kosovë, do të pajisen me licencë, në të kundërtën ata që nuk i plotësojnë kushtet do të refuzohen.

3. Kohëzgjatja e licencës për subjektet që licencohen për importim, tregtim, prodhim, përpunim dhe paketim të farërave lëshohet për periudhën kohore tri vjeçare, me mundësi vazhdimi.

Neni 6

Vazhdimi i licencës

1. Subjektet duhet të paraqesin kërkesë për vazhdimin e licencës për importim, tregtim, prodhim, përpunim dhe paketim të farës, në afatin kohor 30 ditësh para skadimit të afatit të licencës paraqes kërkesë për vazhdim.

2. Në rastet kur subjektet bëjnë shkelje dhe nuk e zbatojnë Ligjin i Kosovës për Farëra Nr. 2003/5, dhe këtë udhëzim administrativ, i pezullohet licenca nga organi kompetent.

Neni 7

Taksa

1. Shuma e taksës për licencim të subjekteve të cilët merren me importim, prodhim, përpunim dhe paketim të farës është 100€ndërsa për vazhdim të licencës 90€

2. Shuma e taksës për licencim të subjekteve të cilët tregtojnë farëra është 80€ndërsa për vazhdim 60€

3. Për Kontrollin në fushat e Vlerës Kultivuese dhe Përdoruese të Varieteteve dhe lëshimin e Certifikatave për fare, paguhen taksat në shumat prej:

- 1.1 Fushat e VKP-s për Drithëra - grurë, elb, tërshërë dhe thekër.....250€/varietet
- 1.2 Fushat e VKP-s për Misër.....250€hybrid
- 1.3 Fushat e VKP-s për Patate.....250€/varietet
- 1.4 Fushat e VKP-s për Lule dielli,Sojë.....250€/varietet
- 1.5 Fushat e VKP-s për Bari, Jonxhë250€/varietet
- 1.6 Taksa e regjistrimit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare.....30€/varietet
- 1.7 Taksë për përfshirje në Listën e varieteteve.....25€/varietet

4. Shuma e pagesës për shtypjen e një etikete për farërat e drithërave dhe patate është 0,025€

Neni 8

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen:

- 1.1 Udhëzim Administrativ Nr. 02/2002 të dt/ 30 shtator 2002 mbi caktimin e tarifës së çmimeve për shërbimet e kontrollit fitosanitar,
- 1.2 Udhëzim Administrativ Nr. 08/2004 të dt. 18 gusht 2004 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2002 të dt. 30 shtator 2002 dhe
- 1.3 Vendimi Ref.ZvM-401/05, dt. 10.11.2006 për shtypjen e etiketave me ngjyrë të bardhë për të gjitha kategoritë e farërave.

Neni 9

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi administrativ, derdhën në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 10

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 24 paragrafi 3. Ligji Nr. 2003/5 i Kosovës për farëra.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, _____2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
